



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 5122/Prot.
12

Pogradec, më 28 .12 .2023

VENDIM

NR 151, DATË 28 .12 .2023

PËR

“PËR MIRATIMIN E NORMAVE, KRITEREVE, RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR MARRJE AMBIENTI DHE OBJEKTI ME QIRA, TË CILAT DO TË SHËRBEJNË SI KOPËSHT DHE SHKOLLË PËR ARSIMIN 9-VJECAR, DERI NË PËRFUNDIM TË PLOTË TË RIKONSTRUKSIONIT TË SHKOLLËS “MYREDIN BASHALLI”, LIN, NJËSIA ADMINISTRATIVE UDËNISHT, BASHKIA POGRADEC”

Në mbështetje të shkronjës "a", shkronjës "c" të pikës 1.2 të nenit 9, në pikën 11 dhe 12 të nenit 23, shkronjës "k", të nenit 54, "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak" të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenin 28 të Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, shkronjës "a", të nenit 7 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Ligjit Nr.10926, datë 08.07.2011, "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, nenit 801 e vijues të Ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe mbështetur tek Relacioni shpjegues i Qendrës Arsimore, pranë Bashkisë Pogradec,

**KËSHILLI I BASHKISË
VENDOSI:**

1. Të miratojë, normat, kriteret, rregullat dhe procedurën për marrje ambienti dhe objekti me qira, për të shërbyer si kopësht dhe shkollë për arsimin 9-vjeçar, deri në përfundim të plotë të rikonstruksionit të shkollës "Myredin Bashalli", Lin, Njësia Administrative Udënisht, të ndodhur në juridiksionin territorial të Bashkisë Pogradec, si më poshtë:



- 1.1 Fshati Lin, Njësia Administrative Udënisht, Bashkia Pogradec.
1.2 Fshati Piskupat, Njësia Administrative Udënisht, Bashkia Pogradec.
2. Ambienti i marrë me qira, të jetë i përshtatshëm për ushtrimin e veprimtarisë “Kopësht publik”, dhe “Shkollë publike”, dhe të jetë në Njësinë Administrative Udënisht.
3. Vlera e qirasë mujore me të cilën do të fillojë procedura e konkurrimit të përcaktohet pas testimit të vlerës së tregut, por jo më shumë se vlerat e poshtë shënuara:
- 3.1 Në të dyja fshatrat Lin dhe Piskupat, Njësia Administrative Udënisht, Bashkia Pogradec, qiraja mujore të mos e kalojë vlerën 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lek në muaj.
4. Procedura e konkurrimit për marrjen e objektit me qira, t’i nënshtrohet hapave si më poshtë:
- 4.1 Struktura e posaçme e krijuar me urdhër të kryetarit të bashkisë Pogradec, të hartojë dhe të publikojë njoftimin për zhvillimin e procedurës së konkurrimit në buletin e publikimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe në këndin e publikimeve pranë Bashkisë Pogradec.
- 4.2 Afati i paraqitjes së ofertave të zgjasë të paktën 7 (shtatë) ditë që nga data e publikimit të njoftimit në buletin e APP-së.
- 4.3 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i krijuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Pogradec, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e hapjes së procedurës konkurruese, të shqyrtojë ofertat e kualifikuara si të rregullta dhe të vlerësojë me çmim më të ulët ofertën/ofertat, dhe të hartojë vendimin për renditjen e ofertuesve.
- 4.4 Subjekteve pjesëmarrëse në konkurrim, t’iu njihet e drejta e ankimit me shkirm, pranë Kryetarit të Bashkisë Pogradec, kundër vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit.
- 4.5 Në përfundim të hapave të mësipërme, të autorizohet Kryetari i Bashkisë Pogradec, për nënshkrimin e kontratës së qirasë.
5. Kohëzgjatja e kontratës së qirasë të jetë deri në përfundimin e vitit shkollor 2023-2024.
6. Për zbatimin e vendimit, ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe e Prokurimeve Publike, Qendra Arsimore e Bashkisë si dhe administrata e Bashkisë Pogradec.
7. Ky vendim hyn në fuqi, 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARË E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

